



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

# **PLANI STRATEGJIK**

## **2017-2020**

Miratuar me Vendimin nr. 18, datë 24.02.2017, të Senatit Akademik të  
Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

**Tiranë, 2017**

# Përmbajtja

<b>Fjala e rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Prof. Arben Gjata .....</b>	<b>3</b>
<b>Historiku i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë .....</b>	<b>6</b>
<b>1. Vizioni .....</b>	<b>9</b>
<b>2. Misioni .....</b>	<b>9</b>
<b>3. Qëllimi .....</b>	<b>9</b>
<b>4. Objektivat .....</b>	<b>10</b>
4.1 Studentët.....	10
4.2 Kurrikula.....	11
4.3 Personeli akademik.....	11
4.4 Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore.....	12
4.5 Financimi .....	12
4.6 Organizimi.....	12
4.7 Bashkëpunimi.....	12
<b>5. Plani i veprimit.....</b>	<b>13</b>
5.1 Studentët.....	13
5.2 Personeli akademik.....	15
5.3 Ndërkombëtarizimi.....	17
5.4 Financimi.....	18
5.5 Organizimi .....	19
<b>6. Përfundime.....</b>	<b>20</b>

## Fjala e rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Prof. Arben Gjata



Qëllimi i këtij dokumenti strategjik është të parashtrojë vizionin e zhvillimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në katër vitet në vazhdim, duke marrë parasysh sfidat e rëndësishme që kemi përpara.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është themeluar më 23.01.2013, si rrjedhojë e ndarjes së Fakultetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Infermierisë nga Universiteti i Tiranës, duke pasur në përbërjen e tij 5 (pesë) fakultete: Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Fakultetin e Mjekësisë Dentare, Fakultetin e Farmacisë dhe Fakultetin e Shëndetit Publik. Në pamje të parë ai rezulton universiteti më i ri publik në Shqipëri, por në të vërtetë ai mbart në vetvete historinë 65-vjeçare të arsimit shëndetësor në vend, që me transformimet e veta mbërriti në stadin e krijimit të një institucioni të arsimit të lartë të dedikuar vetëm për edukimin në fushën e mjekësisë.

Unë kam nderin e madh të jem i pari rektor i zgjedhur i këtij institucioni të nderuar, por njëkohësisht mbaj një përgjegjësi të madhe, që më është ngarkuar nga studentët dhe pedagogët e tij, për të përpiluar një program zhvillimor sfidues por real, ambicioz por të realizueshëm, që do të piketojë rrugën tonë të përbashkët drejt sfidave të mëdha që na vë përpara zhvillimi.

Motoja jonë në këtë rrugë besoj se duhet të jetë: *“Të guxosh do të thotë të realizosh”*. Unë besoj se ne duhet të guxojmë të vëmë përpara vetes objektiva të mëdha, sepse stafi ynë pedagogjik është nga më të përgatiturit në tërë panoramën universitare kombëtare, sepse në radhët tona bën pjesë elita e mjekësisë shqiptare, sepse ne kemi fatin e madh të përthithim gjimnazistët më të mirë, sepse studentët tanë janë ajka e studentëve shqiptarë, sepse unë besoj se së bashku kemi kompetencat dhe energjinë e duhur për të realizuar transformime të mëdha, pasi në thelb universiteti nuk janë auditorët, ambientet, laboratorët apo klinikat, por jeni Ju, të nderuar kolegë e studentë. Unë jam i bindur se janë idetë, bashkëpunimi dhe vullneti për t’i realizuar ato së bashku, motori që mundëson kthimin e ëndrrave në realitet dhe përmbushjen e ambicieve tona.

Këto vite të para të ekzistencës sonë si institucion i pavarur kanë qenë gjithashtu vite sfidash të mëdha për organizimin dhe riorganizimin e strukturave akademike dhe administrative, për plotësimin e kriterëve ligjore, për të bindur opinionin mbi mundësitë e mëdha që ofron pavarësia e institucionit, për rikompozimin dhe ofrimin e programeve sa më të plota për studentët tanë në të gjitha ciklet e studimit, për vendosjen e lidhjeve ndërkombëtare me institucione partnere e për shumë e shumë sfida të tjera. Me këtë rast falënderoj Prof. Jera Krujën dhe Prof. Ali Refatllarin, dy rektorët e emëruar paraardhës, për punën dhe dedikimin e tyre në përballimin e këtyre sfidave.

Përpilimi i këtij plani strategjik katërvjeçar është mbështetur në konsultime të gjera me shumë kolegë dhe studentë, duke analizuar pikat e dobëta dhe të forta të institucionit, duke vlerësuar mundësitë që na ofron zbatimi i ligjit të ri të arsimit të lartë nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, duke vlerësuar përvojën më të mirë ndërkombëtare në fushat e edukimit mjekësor dhe duke u përpjekur që, në përcaktimin e sfidave dhe hapave drejt së ardhmes, të përparojmë me ëndrra e synime, por duke i mbështetur këmbët fort në tokë.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është dhe do të mbetet qendra më e rëndësishme akademike dhe kërkimore e shkencave mjekësore në nivel kombëtar. Përpjekjet tona do të përqendrohen në transformimin e tij në një qendër ekselence mbarëshqiptare dhe rajonale.

Studentët do të jenë në çdo çast në qendër të këtij projekti modernizues. Disa nga objektivat tona me qëllim përmirësimin e ekspertizës që studentët përftojnë gjatë studimit, duke i bërë ata sa më tërheqës për tregun e punës vendas dhe të huaj, janë: forcimi i meritokracisë në përzgjedhjen e tyre; një përgatitje më cilësore teorike, por veçanërisht praktike; krijimi i mundësive që, përveç mësimit, të përfshihen edhe në kërkim shkencor; mundësimi i mobilitetit të tyre mbi bazën e marrëveshjeve dy- apo shumëpalëshe; afrimi i lektorëve të huaj, në formën e lektorëve të ftuar; përmirësimi i infrastrukturës etj.

Reformimi i kurrikulave do të nxitet përmes përqendrimit të prirjet e sotme që po transformojnë kujdesin shëndetësor modern, si kalimi: nga kujdesi shëndetësor individual në atë komunitar; nga kujdesi episodik në atë të vazhdueshëm; nga trajtimi i sëmundjeve akute në atë të sëmundjeve kronike; nga trajtimi i sëmundjes në ruajtjen e shëndetit; nga mosvlerësimi i kostos së trajtimit në kujdesin maksimal për koston.

Personeli akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, përbën elitën e sistemit shëndetësor shqiptar, elitë e cila duhet ruajtur, nxitur dhe zhvilluar. Universiteti do të synojë rritjen e nivelit profesional të stafit pedagogjik nëpërmjet krijimit të hapësirave të patjetërsueshme të lirisë akademike, duke nxitur dhe mbështetur departamentet të përcaktojnë fusha kërkimi, të cilat ndikojnë në drejtim të përpilimit të politikave të zhvillimit të mjekësisë shqiptare, në drejtim të studimeve klinike që përcaktojnë protokolle mjekimi dhe aplikimi, që mund të reflektohen te të gjitha strukturat mjekësore në vend, duke u bazuar te nevojat që paraqet zhvillimi. Një drejtim i rëndësishëm, bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare, do të jetë krijimi i një sektori për shkrimin e projekteve, që bën përpilimin e tyre duke u bazuar tek idetë e stafit tonë pedagogjik, çka do të mundësonte aplikimin për fitimin e granteve të kërkimit,

si nga fondet e brendshme, ashtu edhe nga ato ndërkombëtare. Rikthimi i asistentëve, duke përzgjedhur më të mirët nga profesionistët e rinj të talentuar, që mund të punësohen fillimisht si tutorë me kontrata të përkohshme, për t'i punësuar më vonë si pedagogë me kohë të plotë, përbën një sfidë që synon sigurimin e ekselencës së stafit pedagogjik në të ardhmen.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, do të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndërkombëtarizuar dhe për të shtrirë më tej bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar me universitete dhe institucione të arsimit të lartë apo institucione universitare shëndetësore në fushën akademike, kërkimore-shkencore dhe mjekësore, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe mobiliteti me institucione të tilla, duke nxitur pjesëmarrjen në projekte kërkimore-shkencore të perbashkëta në kuadër të projekteve evropiane apo regjionale, si dhe duke mundësuar mobilitetin ndërkombëtar të studentëve dhe stafit akademik, i cili nxit zhvillimin e potencialit të tyre për të qenë të suksesshëm në një ambient global.

Një nga sfidat më serioze që kemi përpara është dhe financimi i institucionit. Ligji i ri i arsimit të lartë nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*” na hap dyert e tregut, por edhe na vë përpara risqeve që paraqet ky treg. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka si qëllim të fuqizojë financat e tij nëpërmjet: përmirësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të tyre; rritjes së të ardhurave përmes përfshirjes në projekte kërkimore-shkencore; aplikimit të programeve të edukimit në vazhdim, të shtrira për të gjithë mjekët e Shqipërisë; përfshirjes në projekte kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; ofrimit të konsulencës dhe shërbimeve për të tretë; përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve, duke siguruar transparencën dhe efikasitetin e tyre etj.

Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, do të jetë koordinatori dhe nxitësi, që do të promovojë: pavarësinë akademike dhe institucionale, duke përforcuar rolin koordinativ të strukturave të fakulteteve; rritjen dhe forcimin e kompetencave të departamenteve, me synim kthimin e tyre në motorin e vendimmarrjes; nxitjen dhe përpunimin e strategjive të zhvillimit dhe edukimit; rritjen e kompetencave akademike dhe profesionale të shërbimeve universitare, duke mbrojtur dhe promovuar si vlerat më të shenjta forcimin e integritetit dhe kompetencave të trupës akademike, duke pasur në qendër të vëmendjes së të gjithë veprimtarisë së tij studentët e të gjitha cikleve, pasi ata përbëjnë kolonën themelore për të cilën duhet të përkujdesemi të gjithë.

Duke qenë i ndërgjegjshëm se përpilimi i një plani strategjik dhe realizimi i tij mund të arrihen përmes punës dhe përkushtimit tonë të përbashkët, ju ftoj të gjithëve të kontribuojmë me të gjitha kapacitetet që zotërojmë, sepse Universiteti jeni Ju!

*Sinqerisht,*  
Prof. Arben Gjata  
Rektor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

## Historiku i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë (UMT), është qendra historike që mbart traditën shumë të vyer 65-vjeçare të formimit universitar publik në fushën e shkencave mjekësore në Republikën e Shqipërisë. Ai ofron ekspertizën më të lartë profesionale në arsimimin dhe përgatitjen shkencore të specialistëve të shëndetit.

Fillimi i historisë së arsimit të lartë mjekësor shqiptar daton me themelimin e Institutit të Lartë Mjekësor, me Vendimin nr. 381, datë 07.06.1952, të Këshillit të Ministrave.

Instituti i Lartë Mjekësor çeli dyert e tij më 22 shtator 1952. Në vitin e parë të hapjes, ky institucion priti 67 studentët e parë, 13 prej të cilëve ishin femra. Drejtor i parë i institucionit ishte Dr. Aleks Bozo. Programi i studimit i ofruar ishte përgatitja e Mjekëve të Përgjithshëm. Baza spitalore universitare ishte Spitali i Përgjithshëm Civil, Tiranë (sot Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë) dhe institucionet e tjera shëndetësore të vendit, të cilat sot janë spitale universitare. ILM-ja ishte në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Ky institucion ishte një nga pesë fakultetet themeluese të Universitetit Shtetëror të Tiranës në vitin 1957, duke u transformuar në Fakultetin e Mjekësisë. Dekan i parë ishte Dr. Medar Shtylla.

Fakulteti i Mjekësisë u krijua me Vendimin nr. 197, datë 20.05.1957, të Këshillit të Ministrave dhe vazhdoi punën duke ofruar dy degë: degën e Mjekësisë së Përgjithshme dhe, në vitin 1959, degën e Stomatologjisë. Ky krijim solli bazat e zhvillimit të veprimtarisë pedagogjike, edukuese, formuese dhe shkencore dhe Fakulteti i Mjekësisë u shndërrua në qendrën kryesore të mjekësisë shqiptare, duke ofruar standardet më të larta profesionale dhe shkencore.

Në vitin akademik 1957-1958, u krijuan kurset e kualifikimit pasuniversitar afatshkurtër, të cilat në vitin 1981 morën formën e një shkolle pasuniversitare me programe dhe plane të rregullta për 20 kurse specializimi, që plotësonin nevojat për specialistë në shërbimet mjekësore të vendit.

Shumë shpejt, në vitin akademik 1957-1958, u krijuan 15 departamente dhe i gjithë Fakulteti i Mjekësisë, katedrat, laboratorët, kabinetet dhe klinikat, ishin në duart e mjekëve specialistë shqiptarë.

Në vitin 1973, me vendim të Këshillit të Ministrave u përcaktua disiplinimi i procedurës së doktoratave dhe filloi përgatitja e disertacioneve nga ana e pedagogëve për mbrojtjen e titujve shkencorë dhe deri në fillim të viteve 80-të u mbrojtën 30 disertacione.

Në vitin 1959 u krijua Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës, pjesë e të cilit ishte dhe “*Seria Shkencat Mjekësore*”. Gjatë viteve 1975-1980, “*Seria Shkencat Mjekësore*” ishte e angazhuar në 73 tema të ndryshme, 13 prej të cilave ishin me emërtesën “e Këshillit të Ministrave”. Në vitin 2014, Buletini Historik i Shkencave Mjekësore u kthye në revistë universitare në gjuhën angleze, me emërtimin “*Albanian Journal of Medical and Health Sciences*”, që sot mbart vlerat si mjet shkencor ndërkombëtar, me standarde të njohura nga databaza prestigjioze, si NLM-ja dhe ICMJE-ja.

Në kuadër të bashkëpunimit me jashtë, Fakulteti i Mjekësisë priti studentë nga shumë vende të botës, si Bashkimi Sovjetik, Palestina, Kongoja, Indonezia, Siria, si dhe nga Evropa Lindore, të cilët u specializuan kryesisht për kirurgji.

Deri në vitin 1970, dega e Farmacisë ka funksionuar si një katedër e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Pas këtij viti, kjo katedër u përfshi në Fakultetin e Mjekësisë, duke e kthyer atë me tri degë.

Pjesë tjetër e rëndësishme e Fakultetit të Mjekësisë ishte edhe biblioteka shkencore e fakultetit, e themeluar në një kohë me Institutin e Lartë Mjekësor në vitin 1952, e cila është një ndër bibliotekat shkencore më të vjetra dhe më të plota në Republikën e Shqipërisë.

Në vitin 1994 u themelua Shkolla e Lartë e Infermierisë, me Vendimin nr. 494, datë 5.8.1996, të Këshillit të Ministrave *“Për shkollën e lartë të infermierisë”*, ndërsa në vitin 2004 u krijua Fakulteti i Infermierisë i Universitetit të Tiranës, me Vendimin nr. 612, datë 21.09.2004, të Këshillit të Ministrave *“Për shndërrimin e shkollës së lartë të infermierisë në Tiranë, në Fakultet të Infermierisë, në varësi të Universitetit të Tiranës, me kohëzgjatje studimi 3-vjeçar”*.

Fillimisht, pranë Fakultetit të Infermierisë, në janar të vitit 2015 u krijua për herë të parë departamenti i Infermieristikës, me dy seksione: seksioni i Infermieristikës së Përgjithshme dhe seksioni i Infermieristikës Speciale, që mbulonte dy diploma: Infermieri e Përgjithshme dhe Mami. Po ashtu, stafi i Fakultetit të Infermierisë krijoi revistën shkencore *“Mjekësia Bashkëkohore dhe Kujdesi Infermieror”*.

Më 23.01.2013, me Vendimin nr. 48, të Këshillit të Ministrave *“Për krijimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë (UMT)”* u themelua Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Rektore u emërua Prof. Jera Kruja, e pasuar më vonë nga Prof. Ali Refatlari. Me krijimin e Universitetit, në strukturën e tij u bashkuan Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Infermierisë, të cilët u shkëputën nga struktura shumëvjeçare e Universitetit të Tiranës dhe u bënë pjesë përbërëse e pesë njësive kryesore të këtij universiteti, që u ndanë përkatësisht në pesë fakultete: Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Fakulteti i Farmacisë dhe Fakulteti i Shëndetit Publik. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, pas riorganizimit institucional më 30.03.2016, përbëhet nga tri fakultete, Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakulteti i Mjekësisë Dentare, si dhe 22 departamente.

Në zgjedhjet e realizuara më 20 prill 2016, Prof. Dr. Arben Gjata u shpall rektori i parë i zgjedhur i këtij universiteti.

Aktualisht, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, përbëhet nga 303 pedagogë (personel akademik i brendshëm), nga të cilët 80 kanë titullin akademik “Profesor”, si dhe 81 punonjës administrativë. UMT-ja ofron programe të studimit në Mjekësi të Përgjithshme, Farmaci, Stomatologji, Shëndet Publik, Infermieri të Përgjithshme, Teknik Laboratori, Fizioterapi, Mami, Imazheri, Logopedi, Geriatri, si dhe 36 programe specializimi dhe 24 programe doktorate.

Sot, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ofron një imazh të ri dhe bashkëkohor. Ai është institucion i njohur nga FAIMER-i, ECFMG-ja, CGFNS-ja etj. Gjithashtu, UMT-ja është pjesë e rrjeteve

universitare BUA, ORPHEUS, CEEPUS, ERAWEB dhe është universitet partner me shumë universitete të njohura. Nga viti 2014, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, merr pjesë aktive në projekte zhvillimi në Programin e Bashkimit Evropian Erasmus+ dhe në Programin evropian shkencor FP7 dhe Horizon 2020.

Më 29.10.2012, Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani, i akordoi Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Tiranës Urdhrin “Nderi i Kombit”, me nr. Dekreti 7800, ndërsa më 07.06.2016, i akordoi kursit të mjekëve dhe stomatologëve të diplomuar në vitin 1966 në Fakultetin e Mjekësisë titullin “Naim Frashëri”, me nr. dekreti 9626.



## 1. VIZIONI

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është dhe synon të mbetet qendra më e rëndësishme akademike dhe kërkimore e shkencave mjekësore kombëtare.

Ky rol kyç dhe udhërrëfyes në edukim, kërkim shkencor dhe kujdes shëndetësor do të realizohet përmes reformimit dhe modernizimit të institucionit, duke u transformuar kështu në një institucion akademik dhe kërkimor-shkencor mjekësor që:

- frymëzon dhe nxit frymën e bashkëpunimit universitar dhe ndëruniversitar;
- mbështet stafin akademik dhe studentët;
- njeh, mbështet dhe promovon ekselencën;
- kupton, ndjek dhe mbështet nevojat e shoqërisë;
- ofron drejtime dhe shembuj për t'u ndjekur;
- edukon, vlerëson, formon dhe ruan lidhshëpin, duke u mbështetur te vlerat më të mira të traditës dhe të së ardhmes;
- kultivon përsosuri dhe kolegjalitet brenda një komuniteti gjithëpërfshirës.

## 2. MISIONI

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, është një institucion publik i arsimit të lartë mjekësor në Shqipëri, i cili:

- formon dhe edukon profesionistë të shëndetit në të tria ciklet e studimit, sipas standardeve më të larta profesionale;
- realizon dhe nxit kërkimin shkencor;
- frymëzon dhe promovon risitë në fushën e shkencave mjekësore;
- edukon dhe frymëzon liderët e së ardhmes në fushën e mjekësisë.

Ky universitet, në bashkëpunim me studentët, qeverinë, shërbimin shëndetësor dhe shoqërinë civile, transmeton dije dhe përgatit profesionistë të shëndetit që praktikojnë kujdesin optimal ndaj pacientit, me qëllim parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe përparimin e kërkimit shkencor në dobi të shëndetit.

## 3. QËLLIMI

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, si i vetmi institucion publik në fushën e shkencave mjekësore, ka si qëllim të ruajë rolin e udhërrëfyesit në përballjen e sfidave të së ardhmes të kujdesit shëndetësor, duke synuar formimin e profesionistëve të ardhshëm të shëndetit, të orientuar drejt:

- kujdesit mjekësor të mbështetur mbi fakte;
- vlerësimit të cilësisë dhe performancës së kujdesit shëndetësor;
- kalimit nga kujdesi mjekësor spitalor, në kujdesin mjekësor ambulator dhe kujdesin mjekësor në shtëpi;
- mjekësisë së integruar, proaktive dhe parandaluese;
- ofrimit të kujdesit shëndetësor nga ekipe profesionale multidisciplinare dhe interdisiplinare;
- sigurimit të një partneriteti etik midis punonjësve të shëndetësisë dhe pacientit.

## 4. OBJEKTIVAT

Objektivi kryesor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është formimi i profesionistëve të shëndetit të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave mjekësore.

### 4.1 Studentët

Për të arritur këto synime, duhet të përqendrohem në radhë të parë te studentët, të cilët duhet të përbëjnë dhe qendrën tonë të gravitetit.

Një nga synimet kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është forcimi i meritokracisë në përzgjedhje përmes:

- ✓ përmirësimit të sistemit të përzgjedhjes së studentëve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, nëpërmjet hartimit të një formule pranimi sa më realiste;
- ✓ krijimit të mundësive logjistike për realizimin e një konkursi pranimi real, të ndershëm dhe transparent.

Synimi i dytë madhor është përgatitja më cilësore, si nga ana teorike, ashtu dhe nga ajo praktike, e studentëve në fushën e mjekësisë, që do të realizohet nëpërmjet rritjes së cilësisë së aftësisë klinike të tyre, nëpërmjet:

- ✓ aplikimit dhe shtrirjes të metodave të simulimit klinik;
- ✓ zgjerimit të rrjetit spitalor mbështetës;
- ✓ fuqizimit të sistemit tutorial, duke përfshirë të gjithë mjekët e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe rrjetit spitalor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në këtë sistem;
- ✓ përfshirjes aktive në kërkimin shkencor;
- ✓ nxitjes së zhvillimit të metodave multidisiplinare të studimit;
- ✓ nxitjes dhe krijimit të mundësive të lëvizjes së tyre në hapësirën evropiane të arsimit të lartë;
- ✓ rritjes së mbështetjes ndaj tyre përmes shërbimeve administrative dhe shërbimeve të tjera tjera mbështetëse;
- ✓ nxitjes dhe zhvillimit të veprimtarive sportive dhe sociale në komunitet.

Edukimi mjekësor i ditëve të sotme nuk kufizohet thjesht tek ofrimi i njohurive për studentët, por e vë theksin dhe përqendrohet te zhvillimi i kompetencave të nevojshme për të promovuar të mësuarit dhe të vlerësuarit që në auditorët universitarë, duke vazhduar më pas në mënyrë të pandërprerë gjatë të gjithë periudhës së ushtrimit të profesionit. Për të realizuar këto objektiva, synohet të zhvillohen kompetencat si më poshtë vijon:

- vlerësimi kritik i njohurive mjekësore;
- aftësia klinike dhe e kujdesit ndaj pacientit;
- aftësia për kërkim shkencor dhe klinik;
- profesionalizmi në ushtrimin e profesionit;
- aftësitë në fushën e komunikimit dhe të ndërveprimit njerëzor;
- zhvillimi i sistemeve të kujdesit shëndetësor;
- përmirësimi i vazhdueshëm i kujdesit përmes praktikës reflektive.

Një formim universitar mjekësor i suksesshëm është ai që siguron dhe kultivon, jo vetëm aftësitë memorizuese të studentët, por edhe të kuptuarit, të aplikuarit, të analizuarit, të vlerësuarit dhe të krijuarit, në funksion të zhvillimit të dijeve të qëndrueshme në fushën e mjekësisë.

#### **4.2 Kurrikula**

Për të realizuar objektivat, mbetet përparësi përmirësimi i kurrikulave përmes përqendrimit të prirjet e sotme që po transformojnë kujdesin shëndetësor modern, si kalimi:

- nga kujdesi shëndetësor individual në atë komunitar;
- nga kujdesi episodik në atë të vazhdueshëm;
- nga trajtimi i sëmundjeve akute në trajtimin e sëmundjeve kronike;
- nga trajtimi i sëmundjes në ruajtjen e shëndetit;
- nga mosvlerësimi i kostos së trajtimit në kujdesin maksimal për koston;
- të mjekësia e bazuar tek evidencat dhe kërkimi shkencor.

Synimi përfundimtar i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në këtë fushë, duke respektuar dhe përfaqësuar trashëgiminë më të mirë të së shkuarës, është formimi dhe orientimi i profesionistëve të ardhshëm në fushën e mjekësisë drejt të roleve kyç që ata duhet të luajnë gjatë jetës së tyre profesionale në shekullin e ri. Këto role janë si më poshtë:

1. eksperti mjekësor;
2. komunikatori;
3. bashkëpunatori;
4. menaxheri;
5. avokati i shëndetit;
6. nxënësi;
7. profesionisti;
8. kërkuesi shkencor.

#### **4.3 Personeli akademik**

Personeli akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, përbën elitën e sistemit shëndetësor, elitë e cila duhet nxitur dhe zhvilluar nëpërmjet:

- zhvillimit dhe zbatimit të politikave rekrutuese transparente dhe të verifikueshme për një staf ekselent;
- zbatimit të politikave “brain-gain”;
- zbatimit të politikave që nxisin rritjen e performancës së personelit akademik dhe kërkimit shkencor përmes përfshirjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;
- zbatimit të strategjive efektive të rinovimit të stafit, përmes ofrimit të kontratave njëvjeçare për asistentë pedagogë, duke nxitur tërheqjen e stafit të ri akademik;
- zbatimit të procedurave transparente për promovimin akademik;
- krijimit të mundësive për shpërblim në varësi të punës së kryer;
- krijimit të një mjedisi të shëndetshëm dhe miqësor në universitet;
- nxitjes së mendimit dhe diversitetit akademik e shkencor në radhët e stafit akademik;
- nxitjes dhe krijimit të mundësive për lëvizjen e tij në hapësirën evropiane të arsimit të lartë;

- rritjes së mbështetjes ndaj stafit akademik përmes shërbimeve administrative dhe shërbimeve të tjera mbështetëse.

#### **4.4 Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore**

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, do të bëjë të gjitha përpjekjet për të ndërkombëtarizuar dhe për të shtrirë më tej bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar me universitete dhe institucione të larta të arsimit të lartë apo institucione universitare shëndetësore në fushën akademike, kërkimore-shkencore dhe mjekësore. Në këtë mënyrë do të vazhdojë zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunim ndërkombëtar, si dhe do të promovohet lidhja e marrëveshjeve të reja, duke qenë të vetëdijshëm se çdo projekt i përbashkët kërkimor është në funksion të përparimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore në fushën e mjekësisë.

#### **4.5 Financimi**

Për të realizuar objektivat, një rol të rëndësishëm luan financimi që siguron universitetin. Dy burimet aktuale të financimit janë grantet nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat dytësore, që krijohen kryesisht nga tarifat e studimit. Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” krijon hapësira të rëndësishme për të përmirësuar financimin, duke siguruar financime alternative.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka si qëllim të fuqizojë financat e tij përmes:

- përmirësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të financave të tij;
- rritjes së të ardhurave nëpërmjet nxitjes dhe përfshirjes në projekte kërkimore-shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- ofrimit dhe zbatimit të programeve të edukimit në vazhdim për të gjithë profesionistët e shëndetit të Shqipërisë;
- ofrimit të konsulencës dhe shërbimeve për të tretët;
- rritjes së përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor;
- përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve, duke rritur transparencën dhe efikasitetin e tyre;
- ofrimit të fellowship-eve post-specialiteti, me kohëzgjatje 3, 6, 12 dhe 18-mujore, në fusha mjekësore të caktuara, për të cilat kërkohet një formim i veçantë post specialitetit bazë;
- fuqizimit të sistemit on-line të bibliografisë shkencore të stafit akademik dhe përditësimit në vazhdimësi të tij.

#### **4.6 Organizimi**

Realizimi i synimeve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe detyrimeve që rrjedhin nga reflektimi i ndryshimeve ligjore në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” kërkon edhe ndryshime të rëndësishme në organizimin e brendshëm dhe në rivlerësimin e dokumentacionit bazë të universitetit, siç është Statuti dhe Rregullorja e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

#### **4.7 Bashkëpunimi**

Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, Senatit Akademik, dekanatet dhe departamentet, do të jetë koordinatori dhe nxitësi, që do të promovojë:

- pavarësinë dhe lirinë akademike dhe institucionale;
- përforcimin e rolit koordinativ të strukturave të fakulteteve;
- rritjen dhe forcimin e kompetencave të departamenteve, me synim kthimin e tyre në motorin e vendimmarrjes;
- nxitjen dhe përpunimin e strategjive të zhvillimit dhe edukimit;
- rritjen e kompetencave akademike dhe profesionale të shërbimeve universitare, duke i mbrojtur dhe i promovuar ato si vlerat më të shenjta të sistemit akademik mjekësor dhe më gjerë;
- përforcimin e integritetit dhe kompetencave të stafit akademik;
- krijimin e strukturave të reja, të cilat sigurojnë transparencën dhe efektshmërinë e shpenzimeve financiare;
- krijimin e strukturave akademike që do të sigurojnë ofrimin e programeve të edukimit në vazhdim, fellowshipe-ve dhe mbështetjen për përpilimin e projekteve.

## 5. PLANI I VEPRIMIT

Për realizimin e objektivave të mësipërme është përpiluar edhe një plan veprimi, që synon planifikimin dhe monitorimin e hapave të domosdoshme për të mundësuar implementimin e objektivave të parashtruara.

### 5.1 Studentët

#### ➤ **Forcimi i meritokracisë në përzgjedhje**

- Synimi ynë është që në përzgjedhjen e studentëve të ciklit të parë apo në programet master të integruar të sigurohet meritokracia, nëpërmjet vlerësimit të performancës së tyre në shkollën e mesme, duke vlerësuar rezultatet e përgjithshme, rezultatet në lëndët e preferuara për pranimin në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si dhe rezultatet e Maturës Shtetërore.

Kjo formulë do të përpunohet për të qenë sa më afër realitetit.

*Afati: shkurt 2017*

- Aplikimi i konkursit për pranimet në këto cikle studimi në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, mbetet një synim i rëndësishëm, i cili kërkon krijimin e një fondi pyetjesh në formë quiz-i, që do t'i vihet në dispozicion aplikantëve, si dhe ndërtimin e një mjedisi të sigurt dhe të mjaftueshëm, që mundëson një konkurs informatik transparent, të ndershëm dhe të pacenueshem.

*Afati: shtator 2019*

- Pranimet në ciklin e tretë të studimeve do të realizohen duke vlerësuar rezultatet në universitet, intervistën me gojë dhe konkursin informatik, që do të realizohet pranë Agjencisë Kombëtare të Provimeve. Me krijimin e kushteve objektive konkursi informatik do të zhillohet pranë strukturave të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

*Afati: shtator 2019*

#### ➤ **Aplikimi dhe shtrirja e metodave të simulimit klinik**

Metodat e simulimit kërkojnë krijimin e një laboratorit të simulimit klinik, i cili mund të përdoret për formimin dhe testimin e studentëve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë, por edhe si bazë e rëndësishme për

ofrimin e programeve të edukimit në vazhdim. Financimi i tij është i vështirë të realizohet vetëm me financimin e Universitetit, ndaj për ndërtimin e tij do të bëhen aplikime për të siguruar kredi ose grante nga qeveria.

*Afati: përpilimi i projektit mars 2017*

*Afati: aplikimi i projektit viti 2017*

### ➤ **Zgjerimi i rrjetit mjekësor mbështetës**

Për të mundësuar një kontakt sa më të plotë të studentëve me pacientët, përveç spitaleve universitare, synohet që të lidhen marrëveshje edhe me institucione mjekësore jouniversitare, sidomos me poliklinikat dhe struktura të Urgjencës Kombëtare. Marrëveshjet që mund të lidhen me struktura spitalore jouniversitare kërkojnë domosdoshmërisht miratimin nga Rektorati dhe Senati Akademik. Në këto kushte do t'i jepet e drejta dekanateve që, me propozim të departamenteve, të lidhin marrëveshje me strukturat e sipërpërmendura, pa patur nevojë për miratim nga Rektorati apo Senati Akademik.

Për të mundësuar përfshirjen e strukturave spitalore jouniversitare në rrjetin formues të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është i domosdoshëm analizimi i kushteve, kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore të tyre.

*Afati: shtator 2017*

### ➤ **Fuqizimi i sistemit tutorial**

Studentët tanë kanë nevojë për një formim më të mirë praktik. Kjo do të realizohet përmes implementimit të sistemit tutorial në praktikat e drejtuara në të gjitha ciklet e studimit, duke:

- rritur numrin e pedagogëve të jashtëm;
- përfshirë mjekët jouniversitarë të strukturave spitalore apo ambulatorie mjekësore si tutorë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- përfshirë edhe e studentët e të ciklit të tretë në këtë sistem;
- përcaktuar modalitetet e përzgjedhjes dhe shpërblimit të tyre financiar në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

*Afati: prill-tetor 2017*

### ➤ **Përfshirja në kërkimin shkencor**

Realizimi i këtij objektivi të rëndësishëm kërkon implementimin e një sërë hapash që mundësojnë edukimin e studentëve tanë me metodologjinë e kërkimit shkencor, si:

- krijimi dhe fuqizimi i grupeve shkencore në bazë të lëndëve, sipas fushave të studimit që ka departamenti;
- detyrimi për publikime shkencore për studentët e ciklit të tretë;
- punimi i diplomës, si kriter i detyrueshëm për ciklin e dytë;
- reflektimi i këtyre detyrimeve në dokumentet themelore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- ndihma financiare e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për organizimin e aktiviteteve shkencore nga shoqatat apo qeveria studentore.

*Afati: tetor 2017*

➤ **Infrastruktura**

- Përmirësimi dhe krijimi i një infrastrukture akademike dhe shkencore në përputhje me kërkesat e kohës, në mbështetje të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

*Afati: tetor 2018*

- Modernizimi i infrastrukturës teknologjike.

*Afati: tetor 2018*

- Implementimi i plotë i sistemit informatik në menaxhimin e sekretarisë dhe financave në të gjitha fakultetet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

*Afati: tetor 2018*

- Dixhitalizimi i disa funksioneve administrative në mbështetje të studentëve dhe stafit akademik.

*Afati: tetor 2018*

- Fuqizimi i sistemit online të bibliografisë dhe fuqizimi i bibliotekës në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

*Afati: tetor 2018*

➤ **Mobiliteti në hapësirën evropiane të arsimit të lartë, nëpërmjet:**

- lidhjes së marrëveshjeve me universitetet perëndimore;
- transparencës dhe asistencës për të përfituar nga mundësitë e mobilitetit ndërkombëtar;
- përfshirë studentët në projekte të përbashkëta ndërkombëtare.

## **5.2 Personeli akademik**

➤ **Zhvillimi dhe zbatimi i politikave rekrutuese dhe zhvilluese transparente dhe të verifikueshme për një staf ekselent**

Për të përmirësuar procesin e vlerësimit të nevojave dhe mundësitë financiare si dhe gjithë procesin e rekrutimit në përgjithësi nevojitet:

- përpilimi i një udhëzimi nga Rektori mbi afatet e detyrueshme për shpalljen e vendeve vakante dhe realizimin e konkurseve;

*Afati: mars 2017*

- studimi nga çdo fakultet i ngarkesave të çdo departamenti, mbi bazën e lëndëve që zhvillojnë, i ngarkesës së pedagogëve dhe nevojave për staf të ri me daljen e akteve nënligjore që përcaktojnë ngarkesën pedagogjike, si dhe harmonizimi i kësaj ngarkese me nevojat për sistemin tutorial, duke propozuar edhe mënyrën e llogaritjes së ngarkesës për stafin tutorial;

*Afati: maj 2017*

- vlerësimi i kostos financiare për të plotësuar nevojat me staf pedagogjik të brendshëm;

*Afati: qershor 2017*

- përcaktimi i raporteve pedagogjike dhe financiare midis stafit tutorial, stafit pedagogjik të jashtëm dhe atij të brendshëm;

*Afati: shtator 2017*

- procesi i rekrutimit pas vlerësimit të mësipërm.

*Afati: shtator-nëntor 2017*

### ➤ **Promovimi i programeve multidisiplinare të studimit**

Kompetencat profesionale përcaktojnë natyrën e punës së një profesionisti, ndërsa kompetencat ndërprofesionale përcaktojnë proceset e të punuarit, të shoqëruar me synimin e përbashkët të “vendosjes së pacientit në qendër”. Shëndetësia moderne bazohet në ndërveprimin profesional dhe multidisiplinaritetin për arritjen e performancës maksimale në kujdesin shëndetësor.

Prirja aktuale është reformimi i kurrikulës dhe i zhvillimit të karrierës së përhjetshme të profesionistit të shëndetit, duke integruar të mësuarit ndërprofesional me kujdesin e bazuar në stafe multidisiplinare.

Formimi multidisiplinar do të mundësojë edukimin e vazhduar, me fokus kryesisht të mësuarit multidisiplinar, por edhe kultivimin e aftësive teknike (skills) për përdorimin e teknologjive të reja.

Stafet akademike multidisiplinare do të mundësojnë edhe shtimin e gamës së diplomave dhe certifikatave profesionale të lëshuara nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

*Afati: vitet 2019-2020*

### ➤ **Nxitja e rritjes së performancës dhe kërkimit shkencor, nëpërmjet:**

- përcaktimit të fushave të kërkimit shkencor nga departamentet dhe shërbimet klinike, duke u bazuar te nevojat e zhvillimit strategjik të vendit, në bazë të propozimit të tyre apo përgjigjes ndaj kërkesave për studimin e politikave të shëndetit në Shqipëri në mbështetje të Qeverisë Shqiptare, Ministrisë të Shëndetësisë, Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, autoriteteve vendore apo institucioneve publike apo private të parandalimit, diagnostikimit apo trajtimit;

*Afati: shtator 2017*

- nënshkrimit të marrëveshjeve me institucione publike apo private për financimin dhe realizimin e studimeve për të cilat ata paraqesin interes;

*Afati: vitet 2017-2020*

- përfshirjes së stafit akademik në hartimin dhe implementimin e programeve të edukimit në vazhdim apo të programeve fellowship;

*Afati: vitet 2017-2018*

- krijimit të mundësive për të mbajtur leksione apo praktika të drejtuara në institucione ndërkombëtare partnere;

*Afati: vitet 2017-2020*

- aplikimeve për projekte kërkimore kombëtare apo ndërkombëtare, në formën e grupeve të studimit, ku të përfshihen më shumë se një staf akademik nga departamenti apo shërbimi përkatës, si dhe studentë nga ciklet e dyta apo të tret;

*Afati: vitet 2017-2020*

- ligjërimin të mbështetjes financiare për aktivitetet shkencore të stafit akademik, duke bërë reflektimet përkatëse në dokumentet themelore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,.

*Afati: shtator 2017*

### ➤ **Ofrimi i kontratave njëvjeçare për asistentë pedagogë**

- Përshkrimi i këtij pozicioni në dokumentet themelore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.



*Afati: qershor 2017*

- Identifikimi, nga ana e fakulteteve, departamenteve dhe shërbimeve, i lëndëve dhe pozicioneve të asistentë pedagogëve me kontratë të përkohshme, sipas nevojave dhe planeve të tyre të zhvillimit.

*Afati: prill 2017*

- Vlerësimi i efektit financiar.

*Afati: qershor 2017*

- Rekrutimi i stafit.

*Afati: shtator-tetor 2017*

#### ➤ **Përmirësimi i shpërblimit në varësi të punës**

- Reflektimi në dokumentet themelore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i procedurave për të siguruar shpërblime ekstra, në varësi të punës së kryer.

*Afati: qershor 2017*

- Përcaktimi i metodologjisë për përcaktimin e shpërblimit.

*Afati: qershor 2017*

- Vlerësimi i efektit financiar.

*Afati: qershor 2017*

- Implementimi.

*Afati: shtator 2017*

#### ➤ **Nxitja e mendimit dhe diversitetit akademik e shkencor**

- Realizimi i aktiviteteve shkencore dhe konsultuese, të paktën një në vit, mbi mundësitë e përmirësimit të procesit akademik dhe shkencor të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për problematikat e mësipërme.

*Afati: viti 2017*

- Kthimi i departamenteve në qendrën e gravitetit të vendimmarrjes për fushat e studimit, reformimin e kurrikulave dhe programet e edukimit në vazhdim.

*Afati: viti 2017*

### **5.3 Ndërkombëtarizimi**

#### ➤ **Synimet tona për ndërkombëtarizimin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, do të realizohen duke:**

- lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe mobiliteti me insitucione ndërkombëtare;

*Afati: vitet 2017-2020*

- nxitur pjesëmarrjen në projekte kërkimore-shkencore të përbashkëta në kuadër të projekteve evropiane apo regjionale;

*Afati: vitet 2017-2020*

- nxitur lëvishmërinë ndërkombëtare të studentëve dhe stafit akademik, çka nxit zhvillimin e potencialit

të tyre për të qenë të suksesshëm në një ambient global;

*Afati: vitet 2017-2020*

- stimuluar publikime në periodikët më të njohur ndërkombëtarë;  
*Afati: vitet 2017-2020*
- synuar ofrimin e programeve të përbashkëta të studimit në gjuhën angleze me institucione të huaja partnere në fushën e arsimit të lartë në formimin e profesionistëve të shëndetit;  
*Afati: vitet 2017-2020*
- afruar në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, si pedagogë të ftuar, personalitete nga universitete të huaja, duke përfshirë edhe profesionistë shqiptarë që punojnë jashtë vendit.  
*Afati: vitet 2017-2020*

#### **5.4 Financimi**

➤ **Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të financave, si dhe të menaxhimit të shpenzimeve duke rritur transparencën dhe efikasitetin e tyre, nëpërmjet:**

- krijimit të një Këshilli Mbikqyrës të jashtëm, të paktën prej tre specialistësh, të përbërë nga një ekonomist, një jurist dhe një specialist prokurimesh, që do të ketë si funksion vlerësimin e saktësisë dhe transparencës së prokurimeve publike. Përbërja dhe funksionet e tij do të përcaktohen në dokumentet themelore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;  
*Afati: qershor 2017*
- punësimit me kohë të plotë të një specialisti në fushën e ndërtimit, për të vlerësuar teknikisht nevojat e përmirësimit të infrastrukturës të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, mbikëqyrjen e punimeve të rinovimit, si dhe mirëmbajtjen dhe koordinimin e sektorit teknik mbështetës;  
*Afati: prill 2017*
- punësimit me kontratë apo me kohë të plotë të një specialisti me përvojë në fushën e inxhinierisë bio-mjekësore për përpilimin e specifikimeve teknike të pajisjeve të nevojshme për Qendrën e Simulimit Klinik, pajisjeve mjekësore që mund të prokurohen dhe të jetë përgjegjës për mirëmbajtjen e tyre;  
*Afati: prill 2017*
- ndërgjegjësimin dhe ofrimin të mbështetjes për fakultetet dhe departamentet në planifikimin e investimeve dhe projekteve që ata duan të realizojnë, sipas prioriteteve të programit të zhvillimit strategjik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

➤ **Rritja e të ardhurave përmes përfshirjes në projekte kërkimore-shkencore, duke:**

- caktuar një zëvendësrektor të dedikuar për mbështetje për projektet, fellowship-et dhe programet e edukimit në vazhdim;  
*Afati: viti 2017*
- krijuar një sektor mbështetës për hartimin dhe aplikimin e projekteve, ku do të punësohen të paktën 2 (dy) specialistë me përvojë në këtë fushë, që do të paguhen edhe me bonuse, qoftë nga grante kombëtare, qoftë ndërkombëtare, në varësi të projekteve që do të fitohen;  
*Afati: viti 2017*
- përcaktuar një përqindje për çdo projekt të fituar nën siglën e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, e cila do të derdhet në llogarinë e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe do të shërbejë për forcimin dhe zhvillimin e sektorit shkencor;

*Afati: viti 2017*

- treguar transparencë maksimale për mundësinë e aplikimit në projekte jo vetëm nëpërmjet publikimit të tyre në website-in e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, por edhe duke shpërndarë informacionin mbi mundësitë e bashkëpunimit në fushën kërkimore-shkencore dhe duke nxitur departamentet stafin akademik që të aplikojnë për këto projekte.

*Afati: viti 2017*

➤ **Aplikimi dhe ofrimi i programeve të edukimit në vazhdim, të fellowship-eve post-specialiteti, me kohëzgjatje 3, 6, 12 dhe 18-mujore, të konsulencës dhe shërbimeve për të tretët, të shtrira te të gjitha insitucionet dhe profesionistët e shëndetit në Shqipëri, nëpërmjet:**

- ngritjes së qendrës për ofrimin e programeve të edukimit në vazhdim, fellowship-eve dhe mbështetjes së projekteve, që do të përfshijë edhe qendrën e simulimit klinik dhe caktimin e një zëvendësrektori të dedikuar të këtyre fushave;

*Afati: viti 2017*

- nxitjes së departamenteve dhe shërbimeve për përpilimin dhe akreditimin e programeve në këto fusha. Aktivitetet në kuadër të këtyre programeve duhen të lidhen me nevojat e identifikuar nga praktika dhe duhet gjetur një mekanizëm i vlerësimit të kompetencave, performancës dhe rezultateve eventualisht të përmirësuar në saje të këtyre programeve;

*Afati: viti 2017*

- krijimit të një sektori mbështetës dhe mjediseve të nevojshme për ofrimin e këtyre programeve;

*Afati: viti 2017*

- përcaktimit të një formule për çdo program të ofruar, e cila do të shërbejë për vlerësimin e shpërblimit të stafit që ofron programin dhe shpërblimin e institucionit, ku kjo e fundit do të shërbejë për forcimin dhe zhvillimin e sektorit në fjalë.

*Afati: viti 2017*

## **5.5 Organizimi**

➤ **Statuti dhe Rregullorja e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë**

Në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, duhet të reflektohen ndryshimet përkatëse në kuadër të përshtatjes me ndryshimet që rrjedhin nga Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore dhe objektivat që parashikon plani i zhvillimit strategjik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

*Afati: viti 2017*

➤ **Organizimi i brendshëm**

- Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore do të përpilohet organigrama e re dhe skema e vartësisë e strukturave administrative të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

*Afati: viti 2017*

- Plotësimi i organigramës së qendrës për ofrimin e programeve të edukimit në vazhdim, fellowship-eve dhe mbështetjes së projekteve, do të përfshijë edhe qendrën e simulimit klinik dhe caktimin e një zëvendësrektori të dedikuar të këtyre fushave.

*Afati: viti 2017*

## **6. PËRFUNDIME**

Është e qartë se të gjithë bashkë do të ndeshim shumë vështirësi në përballjen me këto sfida, por në të njëjtën kohë jemi të bindur se asnjë synim nuk mund të realizohet nëse i dorëzohemi frikës, rutinës, mediokritetit dhe cinizmit, në vend të solidaritetit, bashkëpunimit dhe transparencës.

Sfidat e mëdha mund të kapërcehen vetëm përmes përpjekjes së përbashkët të atyre njerëzve të guximshëm që besojnë te vizioni i tyre, janë të aftë të qëndrojnë përballë sfidave me fuqinë e ideve të tyre dhe janë në gjendje t'i përballojnë ato në funksion të realizimit të qëllimeve që kanë.